



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.60/01-13587/20
Kaçanik, 03.07.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **III-të (Tretë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete për vitin 2020, mbajtur me datë 03 Korrik 2020. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e Komiteve të Kuvendit të Komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin 6 anëtarët: Lirije Luta-PDK, Kaltrina Tafili-LVV, Nazife Krasniqi-LDK, Hajredin Luta-AAK, Elmihane Krasniqi-Malsiu-HANDIKOS dhe Shemsedin Abazi nga KMLDNJ. Në mbledhje mungoi Naim Hysa nga Kryqi i Kuq.

Nga Zyrtarët e Komunës mori pjesë Vedat Dema, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe për barazi gjinore. Mbledhjen e kryesoi Lirije Luta, Kryesuese e Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtës: Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

zpj.Lirije Luta, Fillimi shëndetësor të pranishmit dhe hapi mbledhjen e III-të (tretë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2020, data 03 Korrik, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete e vitit 2020;
2. Diskutim rreth monitorimit të të drejtave të qytetarëve në Komunën e Kaçanikut dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Komitetit për Komunitete e,

APROVOJ

Redin e punës, në përbërje prej 3 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;

Procesverbal i mbledhjes se II(Dytë) të rregullt të Komitetit për Komunitete i vitit 2020, u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se II (dytë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2020, të datës 17 Qershor 2020/ Lënda 01Nr.60/03-11816/20.

2. Diskutim rreth monitorimit të të drejtave të qytetarëve në Komunën e Kaçanikut

znj.Lirije Luta, Kemi zhvilluar aktivitet , e kemi vizituar zyrën për të drejtat e njeriut. Nëse keni ndonjë pyetje , zyrtarin për te drejtat e njeriut , z.Vedat Dema e keni këtu për sqarime.

z.Vedat Dema, Është raport i vitit 2019 , ky që e keni përparrë jush. Për vitin 2020 nuk kemi aktivitet, për shkak të gjendjes së pandemisë Covid-19. Me 8 mars kemi mbajt ligjérata në shkolla. Arsimtarët e Edukatës fizike e kanë pasur obligim që të mbajnë nga një orë ligjérata për çështjen e barazisë gjinore. Ky raport ka të bëjë me të drejtat e njeriut në Komunën e Kaçanikut. Nuk kemi pasur ndonjë ankesë të parashtruar nga qytetarët e komunës së Kaçanikut. Kemi kontakte edhe me zyrën e Avokatit të Popullit, nëse kemi ndonjë ankesë nga qytetarët. Në shkolla mbajmë ligjérata lidhur me të drejtat e njeriut dhe për çështjen e barazisë gjinore. Kemi pasur takime edhe me Handikos për personat me aftësi të kufizuara. Kemi organizuar tryeza të rrumbullakëta.

z.Shemsedin Abazi, Unë përfaqësoj KMDLNJ në Kaçanik. Në vitet 2008-2010 kemi pasur zyrën për shërbime juridike dhe kemi pasur shumë ankesa. Dihet se në komunën tonë ka shkelje të të drejtave të njeriut sidomos në sektorin privat. Unë mendoj se duhet të kemi një bashkëpunim më të madh. A ka pasur raste të trafikimit me qenie njerëzore në Komunën e Kaçanikut?

z.Vedat Dema, Kemi takime me njësitin kundër dhunës në familjes. Ka raste por mbahen të fshehta. Kemi pasur mekanizëm për këto raste por nuk ka funksionuar sepse nuk ka bazë ligjore. Kemi bashkëpunim edhe me policinë. Sa ju përket ju si KMLDNJ kemi nevojë për bashkëpunim.

z.Shemsedin Abazi, Është mirë të kemi bashkëpunim të gjitha organizatat, si Handikos, Kryqi i Kuq dhe me ju.

znj. Lirije Luta, Në cilat shkolla keni mbajtur ligjérata dhe cilat ishin problemet që i kanë ngritur nxënësit?

z.Vedat Dema, Ligjérata kemi mbajtur në Shkollën e Mesme Profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. Në këtë shkollë janë nxënësit më problematik, mirëpo ne kemi kaluar mirë edhe me nxënësit edhe me stafin. Kemi ligjéruar çështje të ndryshme. Ndërsa në Gjimnazin “Skenderbeu” nuk kanë pranuar të mbajmë ligjérata, me arsyetime të ndryshme nga drejtori. Në Shkollën e Mesme të Ulët “Emin Duraku” kemi mbajtur 12 ligjérata.

znj. Lirije Luta, A ishin në dijeni lidhur me të drejtat e njeriut?

z.Vedat Dema, Ishin në dijeni , mirëpo gjërat kanë ndryshuar për të mirë që nga viti 2008.

Znj.Kaltrina Tafili, Kur i bëni njoftimet për prezencën e zyrtarit nga zyra e Avokatit të Popullit në Komunë?

z.Vedat Dema, Njoftimet i vendosim në derë, në hyrje të Komunës. Nuk i kemi publikuar në faqen zyrtare të komunës. Mirëpo nuk ka pasur interesim të qytetarëve për pjesëmarrje në takime. Ne si zyre vetëm i rekomandojmë qytetarët se ku të drejtohen.

Znj.Elmihane Krasniqi, Gjatë monitorimit tuaj në procedurën e rekrutimit të punëtorëve në institucione , a ka pasur shkelje?

z.Vedat Dema, Më herët i kam monitoruar , por nuk është e mirë ajo që ndodh në procedurat e rekrutimit. Jam zhgënjer dhe nuk marrë pjesë në procedura të rekrutimit të punëtorëve.

Znj.Kaltrina Tafili, Në bazë të asaj që thoni , duhet të mbyllen zyrat për të drejtat e njeriut.

z.Vedat Dema, Nuk mund t'i ankohem Kryetarit për ndonjë shkelje. Edhe në ministri i kemi diskutuar të njëjtat çështje sa i përket mbylljes së zyrës për te drejtat e njeriut.

Znj.Nazife Krasniqi, Para disa viteve një kombibus për shërbime juridike ,ka qëndruar në oborrin e komunës . A ju ka ofruar mundësia ndonjë qytetari të marrë shërbime?

z.Vedat Dema, Kur ka qenë Avokati i Popullit, kemi mbajte takim për çështje të ndryshme. Edhe lidhur me regjistrimin e pronave në emër të dy bashkëshortëve.

Znj.Nazife Krasniqi, Sa i përket statistikave , a keni shënime të regjistrimit të pronave në emër të dy bashkëshortëve?

z.Vedat Dema, Po i kemi statistikat, do t'i dërgojë me email.

Znj.Nazife Krasniqi, Sa i përket çështjes së punësimit të gjinisë femërore a i keni të dhënat?

z.Vedat Dema, Po i kemi të dhënat, të gjitha do tija dërgoj me email.

z.Hajredin Luta, A vjen çdo muaj zyrtari nga zyra e Avokatit të Popullit?

z.Vedat Dema, Po çdo muaj vjen dhe tanë e tutje do të njoftojë në web faqen e Komunës.

z.Hajredin Luta, Në raport shkruan se ka pasur një ankesë, çfarë lloji i ankesës ka qenë?

z.Vedat Dema, Ka qenë kontest gjyqësorë dhe është zgjidhur.

z.Hajredin Luta, Bashkëpunimi ne mes jush dhe policisë është në rregull , mirëpo qytetarët e kanë humbur besimin në polici, policia nuk i mbron sa duhet.

z.Vedat Dema, Ka shumë raste të dhënies së informacioneve nga policia në lidhje me ankesat e qytetarëve, për këtë arsy qytetarët nuk i besojnë policisë. Ka mentalitet të ulët të qytetarëve në komunën tonë. Kemi raste të dhunës në familje. Gruaja ankohet për dhunë në familje dhe me këtë rast dërgohet në strehimore prej 3 deri 6 muaj. Mirëpo prape duhet të kthehet te i njëjti burrë sepse shteti nuk ka çka ti ofron. Ligjet i kemi të mira por nuk kemi buxhet për zbatimin e tyre.

Znj.Kaltrina Tafili, Ne duhet të ndërmarrim hapa, sepse nëse qytetari nuk ka besim në institucione, atëherë kujt t'i drejtohen. Duhet të mundohemi të ndryshomë këtë gjendje.

znej. Lirije Luta, Ky e thotë realitetin, mirëpo kjo ndodh në gjithë Kosovën. Përderisa nuk zbatohen ligjet , ku të drejtohem.

Znj.Kaltrina Tafili, Kam jetuar edhe në shtete të tjera , por shteti i krijon rregullat. Ne duhet të fillojmë t'i ndryshojmë gjërat.

znj. Lirije Luta, Nëse nuk keni diçka tjetër kalojmë në pikën tjetër të rendit të punës.

4.Të ndryshme

Znj.Elmihane Krasniqi, Çka keni bërë në polici në lidhje me rastin e faqes "S'je kaçanikli nëse"?

zpj. Lirije Luta, Ne u takuam me policinë edhe ato ishin të shqetësuar me rastin. Ne si anëtarë të Komitetit për Komunitete e kemi ftuar në një takim , mirëpo nuk është përgjigjur. Në takim me KKSBB kemi debatuar lidhur me këtë temë, mirëpo sipas komandantit të policisë këtu në Kaçanik, ato i mbron ligji. Deri sa të bëhen 3-4 ankesa , pastaj mund të ngritët padi.

Znj.Elmihane Krasniqi, Unë nuk kam pasur ankesë vetëm ndaj tij sepse lajmi i është dhënë nga dikush tjetër, mirëpo është dashtë të konsultohet me mua si përfaqësuese e Handikosit.

z.Hajredin Luta, A do të kemi ndonjë aktivitet?

Znj.Elmihane Krasniqi, Kërkoj nga ju të kemi takime online për shkak të gjendjes së Pandemisë Covid-19, kushdo që keni mundësi.

zpj. Lirije Luta, Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:56.

Procesmbajtës
Arbnora Kuka

